111	A monitoron niveli drejtues i njësisë publike statusin e veprimeve korrigjuese në mënyrë që ato të përfundojnë në kohën e duhur dhe të sjellin rezultatit e pritur (p.sh. rekomandimet e auditimit të brendshëm ose rezultatet e aktiviteteve monitoruese)?	1. Plani i Veprimit për KB (kolona statusi); 2. Raporti vjetor i auditorit të brendshëm.	Zbatim i rekomandimeve monitorohet në vazhdimësi nga drejtuesi i njesisë publike, titullari i saj, nëpërmjet raporteve dhe mbledhje që titullari organizon me GMS dhe Keshillin e Gjykatës.

K/D/BUXHETIT  
MIMOZA DEDJA



ZV/KRYETAR  
ABBAN DVORAN



REGJISTRI I RISKUT PER VITIN 2023

EMRI I NJESISE: Gjykata Administrative e Apelit

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Nr.	Përshkrimi i Riskut	Risku para kontrollit probabiliteti/impakti	Kontrollet ekzistuese	Risqet pas kontrolleve ekzistuese probabiliteti /impakti	Nevoja për kontrolle të mëtejshme	Veprime për të adresuar boshlleqet	Zotëruesi i riskut	Ndryshimet në risk që nga detyra e fundit (përkeqësohet => përmirësohet <= i pandryshuar = )	Ndonjë koment tjetër
1	Zgjatja e afateve të gjykitimit të çështjeve si pasojë e mungesës në organikë	I lartë	Kërkesat e vazhdueshme ne Ministri dhe KLGJ për shtesë organike.	I larte	PO	Kontakte të vazhdueshme me specialistet e KLGJ	KLJG		
2	Mungesa e numrit te duhur ne organike te gjyqtareve si dhe levizjet e mundeshme si rezultat i reformes ne drejtesi gjate vitit 2023	I lartë	Kërkesat e vazhdueshme ne Ministri dhe KLGJ për shtesë organike.	I larte	PO	Kontakte të vazhdueshme me specialistet e KLGJ	KLJG		
	Risku i jashtem i rritjes se cmimeve te mallrave kryesisht leter, tonera, pjese kembimi, energjiise elektrike, posta, Karburant,	I mesem	Analiza e cmimeve ne menyre racionale.	I mesem	PO	Kerkesa te detajuara prane KLGJ, ndryshim te regjistrin te prokurimeve, mbajtja nen kontroll e konsumit sipas normativave ne keto sherbime.	Kancelari Gjykates Komisioni Blerjeve te vogla.		
	Ndryshimi I here pas hershem I punonjesve te administrates si pasoje e largimit me doreheqje, ne institucione te tjera dhe ardhje e punonjesve te rinj te pa trajnuar.	I ulet	Trajnime brenda institucionit	I ulet	PO	Matja e performancës se punonjesve të rinj në fund viti.	Zv/Kryetari i Gjykatës/ Kancelari/		

5	Qendrim i vazhduar jashte orarit te punes	I ulët /	Organizimi i punes dhe kapaciteti i burimeve njerezore	I ulët	JO
5	Rritja e kërkesës për trajnime për administraten, nisur nga fakti që ka punonjës të rinj.	I mesëm	Trajnime brenda institucionit nga punonjës me experience.	I mesëm	PO
7	Risku i brendshem se rritja e volumit te ceshtjeve gjyqesore do te sjelle kosto me te larte per njesi produkti pra me teper shpenzime se planifikim	I mesem	Analiza e numrit te ceshtjeve gjyqesore per nje periudhe 3-vjecare.	mesem	PO
8	Risku i brendshem nga mungesa e organikes me specialiste perkates per prokurimet publike	I ulet	Kërkesat e vazhdueshme ne Ministri dhe KLGJ për shtesë organike.	I ulet	PO
	Mungesa e ambjenteve të magazines dhe Arshivave	I lartë	Diskutimet e vazhdueshme me Keshillin e gjykatës dhe GMS për të përshtatur ambjentet ekzistuese. Risku i lartë përse i përket magazinimit dhe ruajtjes se aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra si dhe dosjet gjyqesore te ardhura per gjykim.	I larte	Po
0	Mungesa e ambjenteve të punës për punonjësit e rinj	I lartë	Diskutimet e vazhdueshme me Keshillin e gjykatës dhe GMS për të përshtatur ambjentet	I larte	Po

Shperndarja e punes	Zv/Kryetari Kancelari		
Kërkesa prane KLGJ /propozim per trajnime te administrates . Matja e performancës se punonjesve të rinj në fund viti.	Zv/Kryetari i Gjykatës/ Kancelari/		
Kerkese KLGJ, per shtese personeli me gjyqtar.	Zv/Kryetari i Gjykatës/ Kancelari/ K/D/ Buxhetit		
Kontakte të vazhdueshme me specialistet e KLGJ	Zv/Kryetari i Gjykatës/ Kancelari/		
Kërkesa të vazhdueshme në KLGJ për mungesë ambjentesh.	Këshilli I Gjykatës dhe GMS		
Kërkesa të vazhdueshme në KLGJ për mungesë ambjentesh.	Këshilli I Gjykatës dhe GMS		



		ekzistuese. Risku i lartë përsa I përket ndarjes së ambjenteve të punës me një numër të madh punonjësish , sic zyrat e sekretareve e ndihmesave ligjor						
11	Mungesa e adresave të sakta sjell rritjen e shpenzimeve të postës, pasi shkresat përsëriten dhe zgjaten e proceset gjyqësore.	I mesëm	Kontaktet e shumta me Postën që most ë pranojë shkresa në drejtim të gjykatës pa qenë adresat e sakta.	I mesëm	po	Rritja e shpenzimeve shoqërohet me kërkesë KLGJ për shtesë fondi.	Kancelari Kryetare e Degen Buxhetit .	
12	Mungese organike ne Degen e Buxhetit	I mesem	Kontroli I vazhdueshem ne dokumentacionin financiar nga menazhimi I larte.	I mesem	po	Plotesimi i organikes ne Degen e Buxhetit	ZV/Kryetari Kancelari	

**ZËVËNDËS KRYETAR**

**ARDIAN DVORANI**





---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR  
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

RAPORT AUDITIMI  
PËR  
GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË APELIT

Tiranë, Shkurt 2024

## 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjykata Administrative e Apelit funksionon në bazë të Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligjit Nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe ligjeve të tjera për administrimin publik.

Auditimi u krye në zbatim të Ligjit Nr.114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, Kapitullit IV të Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik, miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar, Udhëzimit të MFE nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”, planit vjetor të auditimit, të miratuar për vitin 2024 me nr.5130/2 Prot. datë 5.10.2023 dhe programit të angazhimit të auditimit nr.1, ref. nr.399/1, prot datë 22.1.2024.

Objekti i auditimit: Verifikimi dhe vlerësimi i monitorimit, mbi ecurinë dhe progresin e bërë për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm.

Qëllimi i auditimit: Dhënja e sigurisë objektive dhe të arsyeshme Titullarit mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm të ngritura, nëse gjetjet nga auditimi i mëparshëm janë adresuar në mënyrën e duhur, rekomandimet e lëna janë zbatuar sipas afateve të miratuara dhe veprimet e ndërmarra nga gjykata janë zbatuar me efektivitet në realizimin e objektivave.

Periudha e auditimit: deri më 31.12.2023

Përmbledhja e rezultateve nga vlerësimi: Gjykata Administrative e Apelit është audituar nga DAB-ja në muajin Tetor të vitit 2023, për periudhën 1.1.2019 deri më 31.3.2023 ku në përfundim janë lënë 13 rekomandime për zbatim. Gjykata ka reaguar në lidhje me rekomandimet e lëna në raportin e auditimit nëpërmjet pranimit të plotë të tyre, hartimit e miratimit të planit të veprimit dhe afatet për zbatimin e rekomandimeve.

Nga vlerësimi i monitorimit, mbi ecurinë dhe progresin që është bërë për zbatimin e 13 rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, rezultojnë se janë zbatuar plotësisht 6 ose 46 %, në proces zbatimi (papërfunduar plotësisht) 7 ose 54 % dhe pa zbatuara, sika. Rekomandimet në proces zbatimi janë si më poshtë:

Rekomandimi nr.1: Për të bashkëpunuar me organin qendror (për sigurimin e fondeve), duke analizuar dobësitë, hartimin e një plan veprimi për garantimin e rregullit dhe të sigurisë në gjykatë në përputhje me standardet e kerkuara.

Rekomandimi nr.2: Për një administrim më efektiv dhe rritjen e sigurisë fizike në Dhomën e Serverave në drejtim të uljes së riskut, në bashkëpunim me organin qendrorë (për sigurimin e fondeve) marrja e masave të nevojshme për përmirësimin e kushteve të sigurisë, sipas standardeve të miratuara për ndertimin dhe administrimin e dhomes se serverave per Sistemin e Drejtesise.

Rekomandimi nr.3: Për krijimin e kushteve teknike dhe teknologjike për ruajtjen dhe sigurinë fizike të dokumentave në zyrën e arkivës; përdorimin e vetëm nje regjister korespodence për regjistrimin e shkresave hyrëse, dalëse dhe të brendshme. Ngritjen e komisionit të ekspertizës, për hartimin e listës konkrete me afatet e ruajtjes së dokumentave të gjykatës.

## RAPORT AUDITIMI

---

*Rekomandimi nr.4:* Për përfshirjen në grupin e punës për përgatitjen e PBA-së (EMP) të gjithë drejtuesit e aktiviteteve/strukturave të gjykatës; planifikimin dhe paraqitjen e treguesve buxhetorë për të tre vitet e periudhës së programit buxhetor afatmesëm; administrimin e të gjithë dokumentacionit bazë i përgatitjes së PBA-së lidhur me kërkesat për mallra e shërbime nga cdo sektor/strukturë, analizimin e tyre bazuar në normativa/eksperiencat e mëparshme si dhe mënyrën e përlllogaritjes së vlerës së kërkesave.

*Nga verifikimi rezulton se: Në buxhetin e miratuar të vitit 2024 janë miratuar fonde gjithsej 1,500 mijë lekë për investime të cilat do të përdoren për të rritur sigurinë fizike në vendosjen e mbrojtëses prej hekuri në dritaret, dyert dhe pajisjen e lagështisë në arkivë.*

*Për adresimin dhe zbatimin e plotë të rekomandimit nr.1, nr.2 dhe nr.3, që kanë të bëjnë me përmirësimin e kushteve për sigurinë në gjykatë, si dhe ruajtjen dhe sigurinë fizike të dhomës së serverit dhe arkivës, gjykata po harton planin e veprimit shoqëruar me kërkesat buxhetore në programin buxhetor afatmesëm 2025-2027 për investimet e nevojshme në vitet në vazhdim. Sipas Udhëzimit nr.7 datë 28.2.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së PBA-së" dhe kalendarit të miratuar nga KLGJ-ja faza e I-rë e përgatitjes së PBA-së fillon në muajin Shkurt të vitit 2024.*

*Kancelari i gjykatës me emalin e datës 23.1.2024 i ka dërguar stafit sipas sektorëve të gjykatës për paraqitjen me shkrim të kërkesave buxhetore veçanërisht për investimet që lidhen me kushtet e sigurisë.*

*Përdoret vetëm një regjister korespondence për regjistrimin e shkresave hyrëse, dalëse dhe të brendshme. Me vendimin nr.519 prot datë 17.11.2023, komisioni i ekspertizës ka miratuar listën konkrete me afatet e ruajtjes së dokumentave në gjykatë.*

*Gjithashtu rekomandimi nr.4 në lidhje me përmirësimin e kërkesave në përgatitjen e PBA-së do të gjejë zbatim të plotë në fazën e I-rë të hartimit të PBA-së 2025-2027.*

*Rekomandimi nr.5:* Për analizimin në GMS/ Këshillin e Gjykatës të raporteve periodike dhe vjetore të monitorimit të zbatimit të buxhetit vjetor dhe performancës financiare ku përvec evidentimit të arsyeve dhe shkaqeve të mospërputhjeve midis planit dhe faktit të treguesve të shoqërohet me përcaktimin e miratimit e veprimeve që duhet të ndërmerren për përmirësimin e performances financiare në uljen e kostos për çështje të gjykuar.

*Nga verifikimi rezulton se: Në bazë të Udhëzimit të MFE nr.22, datë 17.11.2016 "Për procedurat standarde të monitorimit të zbatimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore", afati për raportimin vjetor të monitorimit të zbatimit të buxhetit është fundi i muajit Shkurt të vitit 2024, kohë në të cilin ky rekomandim do gjejë zbatim të plotë.*

*Rekomandimi nr.6:* Për më shumë kujdes në hartimin dhe argumentimin e kriterëve të veçanta të kualifikimi. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Në mënyrë që të eliminohet zgjatja e panevojshme të procedurave të prokurimit, sigurimi i konkurrencës dhe barazia në tendera.

*Rekomandimi nr.7:* Për përcaktimin qartë në kushtet e ftesës për ofertë dhe në kontratën e furnizimit me karburant, që furnizimi /ngarkimi në sistemin elektronik të administrimit të karburantit të jetë në bazë të kërkesave periodike mujore të gjykatës dhe faturimi nga kontraktori/shitesi të jetë në fund të çdo periudhe/muaji për sasinë e karburantit të konsumuar. Mbi bazën e faturës të blerjes periodike/mujore të pritit flet hyrja e shoqëruar me raportin nga sistemi elektronik i administrimit të karburantit dhe kuponat tatimore të furnizimit të çdo mjeti dhe njëkohësisht të pritit fletëdalja (dokumenti vërtetues) e cila të

## RAPORT AUDITIMI

---

shoqërohet me fletë udhëtimet e dorëzuara nga drejtuesi i mjetit për justifikimin e konsumit të karburantit.

*Nga verifikimi rezulton se: Deri në momentin e auditimit nuk është zhvilluar asnjë procedurë prokurimi përfshirë dhe furnizimin me karburant për të verifikuar nëse këto dy rekomandime kanë gjetur zbatim.*

**Konkluzioni i përgjithshëm:** Gjykata ka vlerësuar rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm dhe ka ndërmarrë hapa konkrete për zbatimin e tyre. Nisur nga fakti që shumica e rekomandimeve që janë në proces janë brenda afateve të zbatimit të tyre, niveli i zbatimit të rekomandimeve është i pranueshëm:

- Rekomandime të lëna 13.
- Rekomandime të zbatuara plotësisht 6 ose 46 %.
- Rekomandime ne proces zbatimi (papërfunduar plotësisht) 7 ose 54%.
- Rekomandime të pazbatuara, ska.

Masat e marra për zbatimin e tyre kanë ndikuar në përmirësimin e funksionimit të veprimtarisë dhe arritjen e objektivave.

Në vijim të raportit në pikën 4 “*Vlerësimi i monitorimit, mbi ecurinë dhe progresin që është bërë për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm*”, jepet informacion i detajuar për çdo rekomandim.

## 2. HYRJE

Në Gjykatën Administrative të Apelit, u realizua auditim për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

**Baza Ligjore:** *Auditimi u krye mbështetur në dispozitat ligjore të mëposhtme:*

1. Ligji 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Ligji Nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
3. Ligji nr 115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar.
4. Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
5. Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
6. Ligji Nr.10296, datë 08. 07. 2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.
7. Ligji nr. Nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar
8. Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave Nr. 100, datë 25.10.2016, “Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar.
9. Udhëzimi i MFE nr.42, date 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”.

Për fillimin e angazhimit të auditimit, grupi auditimit në datën 23.1.2024, prezantoi qëllimin dhe drejtimit e auditimit dhe paraqiti kërkesën për dokumentacion që duhet ti vihej në dispozicion grupit të auditimit deri në datën 26.1.2024.

Angazhimi i auditimit u krye nga grupi i auditimit të përbërë nga:

Z. Agim Koçi	- auditues,
Z. Auken Herri	- auditues

## RAPORT AUDITIMI

---

Afati i Auditimit: 23.1.2024 - 2.2.2024.

Grupi auditimit në datën 26.1.2024 mbas vlerësimit të dokumentacionit për progresin e zbatimit të rekomandimeve plotësoi pasqyrën nr.2 “Verifikimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm për vitin 2023”, bashkalidhur këtij raporti.

### 3. METODA E AUDITIMIT

Në angazhimin e auditimit janë përdorur metoda dhe teknika auditimi si: intervistimi, krahasimi, leximi dhe studimi i raporteve, etj.

Dokumentacioni i verifikuar u përzgjedh me kampion sipas vlerësimeve të kryera për drejtimin e audituar.

Vlerësimi i kampioneve të dokumentacionit ju nënshtua përputhshmërisë me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe llogaritjeve të kryera nga punonjësit përkatës.

Kampionet u morën me teknikat e zgjedhjeve rastësore por dhe kohore dhe u shtrinë në të gjithë periudhën e auditimit, konkretisht: Listëpagesa, libra kontabël, urdhër shpenzime, shkresa e korespondenca të zhvilluara, vendime, urdhëra etj.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Gjatë auditimit si teknika auditimi u përdoren: sondazhet, përzgjedhja në mënyrë rastësore, kombinuar me teknika të tjera si kontrolli aritmetik (mandatet, librat e arkës, etj), shqyrtimi i dokumentave justifikuese e krahasimi me dokumentin bazë.

U vlerësua hartimi dhe zbatimi i plan veprimit mbi rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm.

Grupi i auditimit gjykoj se ky dokumentacion është i mjaftueshëm për të mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve.

### 4. Vlerësimi i monitorimit, mbi ecurinë dhe progresin që është bërë për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Në raportin përfundimtar të auditimit të mëparshëm, dërguar me shkresën Nr. 4660/3 prot, datë 12.12.2023 në gjykatë, janë lënë 13 rekomandime për zbatim.

Gjykata, ka reaguar brenda afatit 30 ditor me shkresën e dërguar DAB-së në KLGJ nr.39 prot. datë 8.1.2024 në lidhje me masat që do merren për zbatimin e rekomandimeve të lëna duke dërguar informacion në lidhje me zbatimin e tyre.

Në zbatim të Planit të Veprimit të miratuar nga zv/Kryetari Gjykatës për cdo rekomandim të lënë, ka filluar ndjekja dhe zbatimi i tyre sipas personave/strukturave dhe afateve të caktuara.

Nga ana e grupit të auditimit u vijua me verifikimin në datat 23.1.2024 deri në datën 26.1.2024 në vend/gjykatë të veprimeve të ndërmarra sipas shpjegimeve dhe dokumentacionit justifikues/vërtetues të vënë në dispozicion nga gjykata.

Nga verifikimi, statusi i 13 rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm rezulton si më poshtë:

- **Rekomandime për përmirësimin e sistemeve**

**Rekomandimi nr.1:** Gjykata në bashkëpunim me organin qendror (për sigurimin e fondeve), duke analizuar dobësitë, të hartohet një plan veprimi për garantimin e rregullit të sigurisë në gjykatë në përputhje me standardet e kerkuara.

---

## RAPORT AUDITIMI

---

*Niveli i riskut: I mesëm*

*Afati i zbatimit: Deri 30 Mars 2024*

**Rekomandimi nr.2:** Gjykata për një administrim më efektiv dhe rritjen e sigurisë fizike në Dhomën e Serverave në drejtim të uljes së riskut, në bashkëpunim me organin qendrorë (për sigurimin e fondeve) të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e kushteve të sigurisë, sipas standardeve të miratuara për ndertimin dhe administrimin e dhomes se serverave per Sistemin e Drejtesise.

*Niveli i riskut: I mesëm*

*Afati i zbatimit: Deri 30 Qershor 2024*

**Rekomandimi nr.3:** Të krijohen kushtet teknike dhe teknologjike për ruajtjen dhe sigurinë fizike të dokumentave në zyrën e arkivës.

Të përdoret vetëm nje regjister korespondence për regjistrimin e shkresave hyrëse, dalëse dhe të brendshme.

Të ngrihet komisioni i ekspertizës, për hartimin e listës konkrete me afatet e ruajtjes së dokumentave të gjykatës.

*Niveli i riskut: I mesëm*

*Afati i zbatimit: Deri 30 Qershor 2024*

**Rekomandimi nr.4:** Grupi i punës për përgatitjen e PBA-së (EMP) për një planifikim gjithëpërfshirës e sa më real të nevojave të ketë në përbërje të gjithë drejtuesit e aktiviteteve/strukturave të gjykatës; planifikimi dhe paraqitja të treguesve buxhetorë të jetë për të tre vitet e periudhës së programit buxhetor afatmesëm; të administrohet i gjithë dokumentacioni bazë i përgatitjes së PBA-së lidhur me kërkesat për mallra e shërbime nga cdo sektor/strukturë, analizimin e tyre bazuar në normativa/eksperiencat e mëparshme si dhe mënyrën e përlllogaritjes së vlerës së kërkesave.

*Niveli i riskut: I mesëm*

*Afati i zbatimit: Menjëherë*

**Statusi i rekomandimit nr.1, 2, 3 dhe 4 : Në proces zbatimi (të papërfunduar plotësisht).**

Në buxhetin e miratuar të vitit 2024 janë miratuar fonde gjithsej 1,500 mijë lekë për investime të cilat do të përdoren për të rritur sigurinë fizike në vendosjen e mbrojtëses prej hekuri në dritaret, dyert dhe pajisjen e lagështisë në arkivë.

Për adresimin dhe zbatimin e plotë të rekomandimit nr.1, nr.2 dhe nr.3, që kanë të bëjnë me përmirësimin e kushteve për sigurinë në gjykatë, si dhe ruajtjen dhe sigurinë fizike të dhomës së serverit dhe arkivës, gjykata do hartojë planin e veprimit shoqëruar me kërkesat buxhetore në programin buxhetor afatmesëm 2025-2027 për investimet e nevojshme në vitet në vazhdim. Sipas Udhëzimit nr.7 datë 28.2.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së PBA-së” dhe kalendarit të miratuar nga KLGJ-ja faza e I-rë e përgatitjes së PBA-së fillon në muajin Shkurt të vitit 2024. Në zbatim të këtyre rekomandimeve dhe për ti paraprirë procesit të përgatitjes së PBA-së, kancelari i gjykatës me emalin e datës 23.1.2024 i ka dërguar stafit sipas sektorëve të gjykatës për paraqitjen me shkrim të kërkesave buxhetore vecanërisht për investimet që lidhen me kushtet e sigurisë.

Përdoret vetëm nje regjister korespondence për regjistrimin e shkresave hyrëse, dalëse dhe të brendshme. Me vendimin nr.519 prot datë 17.11.2023 të komisionit i ekspertizës të ngritur, është miratuar lista konkrete me afatet e ruajtjes së dokumentave të gjykatës.

Gjithashtu rekomandimi nr.4 në lidhje me përmirësimin e kërkesave në përgatitjen e PBA-së do gjejë zbatim të plotë në fazën e I-rë të hartimit të PBA-së 2025-2027.

**Rekomandimi nr.5:** Përgatitja e raporteve periodike dhe vjetore të monitorimit të zbatimit të buxhetit vjetor dhe performancës financiare të analizohen në GMS/ Këshillin e Gjykatës ku përvec evidentimit të arsyeve dhe shkaqeve të mospërputhjeve midis planit dhe faktit të treguesve të shoqërohet me

## RAPORT AUDITIMI

---

përcaktimin e miratimit e veprimeve që duhet të ndërmerren për përmirësimin e performances financiare në uljen e kostos për çështje të gjykuar.

*Niveli i riskut: I mesëm*

*Afati i zbatimit: Menjëherë*

**Statusi i rekomandimit:** Në proces zbatimi (i papërfunduar plotësisht). Bazuar në Udhëzimin e MFE nr.22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të zbatimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”, afati për raportimin vjetor të monitorimit të zbatimit të buxhetit është fundi i muajit Shkurt të vitit 2024, kohë në të cilin ky rekomandim do gjejë zbatim të plotë.

**Rekomandimi nr.6:** Njësia e Prokurimit të tregojë më shumë kujdes në hartimin dhe argumentimin e kriterëve të veçanta të kualifikimi. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Në mënyrë që të eliminohet zgjatja e panevojshme të procedurave të prokurimit, sigurimi i konkurrencës dhe barazia në tendera.

*Niveli i riskut: I mesëm*

*Afati i zbatimit: Menjëherë*

**Rekomandimi nr.7:** Në kushtet e vendosura në ftesën për ofertë dhe në kontratën e furnizimit me karburant, të përcaktohet qartë që furnizimi /ngarkimi në sistemin elektronik të administrimit të karburantit të jetë në bazë të kërkesave periodike mujore të gjykatës dhe faturimi nga kontraktori/shitesi të jetë në fund të çdo periudhe/muaji për sasinë e karburantit të konsumuar. Mbi bazën e faturës të blerjes periodike/mujore të pritët flet hyrja e shoqëruar me raportin nga sistemi elektronik i administrimit të karburantit dhe kuponat tatimorë të furnizimit të çdo mjeti dhe njëkohësisht të pritët fletëdalja (dokumenti vërtetues) e cila të shoqërohet me fletë udhëtimet e dorëzuara nga drejtuesi i mjetit për justifikimin e konsumit të karburantit.

*Niveli i riskut: I mesëm*

*Afati i zbatimit: Menjëherë*

**Statusi i rekomandimit nr.6 dhe nr.7 :** Në proces zbatimi (të papërfunduar plotësisht). Deri në momentin e auditimit nuk është zhvilluar asnjë procedurë prokurimi përfshirë dhe furnizimin me karburant për të verifikuar nëse këto dy rekomandime kanë gjetur zbatim.

**Rekomandimi nr.8:** Për çdo pozicion pune vakant, të zhvillohet procedura e rekrutimit/pranimimit në punë. Të mos emërohen punonjës që nuk përmbushin kriteret e veçanta të pozicionit të punës/emërimi të bëhet me konkurim të hapur. Të ndërpriten marrëdhëniet financiare/punës me sekretarin gjyqësor (H.T).

*Niveli i riskut: I mesëm*

*Afati i zbatimit: Menjëherë*

**Statusi i rekomandimit:** Zbatuar plotësisht. Me vendimin nr.471/1 datë 12.10.2023 të zv/Kryetarit të Gjykatës është miratuar kërkesa për dorëheqje e sekretarit gjyqësor (H.T) dhe ndërprerja e marrëdhënieve financiare/punës me të. Zbatimi i rekomandimit për emërimin e punonjësve me konkurim të hapur dhe që përmbushin kriteret e veçanta të pozicionit të punës do vlerësohet në periudhat e ardhshme pasi deri në momentin e auditimit nuk është zhvilluar akoma procedurë rekrutimi të nëpunësve civilë gjyqësorë.

**Rekomandimi nr.9:** Struktura përgjegjëse për burimet njerëzore të marrë masa duke rishikuar dhe sistemuar vjetërsinë në punë të dokumentuar në librezat e punës duke llogaritur si vite pune për efekt të kësaj shtese përcaktimet në aktet ligjore në fuqi.



## RAPORT AUDITIMI

---

Struktura përgjegjëse për financat të bëjë sistemimet përkatëse nëse rezultojnë diferenca në shtesën e pagës dhënë për vjetërsinë në punë, duke bërë dhe sistemimet në pagë për rastet e konstatuara.

*Niveli i riskut: I mesëm*

*Afati i zbatimit: Menjëherë*

**Statusi i rekomandimit: Zbatuar plotësisht.** Janë rishikuar e sistemuar vjetërsitë në punë në librezat e punës sipas përcaktimeve në aktet ligjore në fuqi. Pas rishikimit ka rezultuar se janë paguar padrejtësisht/më shumë për vjetërsinë në punë për të cilat janë bërë rilogaritjet dhe janë ndaluar në listëpagesën e muajit Tetor 2023. Konkretisht sekretarja gjyqësore (B.LL) është paguar me shtesë për 4 vite më shumë, për 22 muaj nga Dhjetor 2021 deri Shtator 2023 me një efekt prej 29,582 lekë dhe specilisti i IT-së është paguar me shtesë për 7 vite më shumë, për 10 muaj nga Dhjetor 2022 deri Shtator 2023 me një efekt prej 23,749 lekë.

**Rekomandimi nr.10:** Struktura përgjegjëse për burimet njerëzore të marrë masa për kategoritë e punonjësve që trajtohen me shtesë për natyrë të veçantë pune duke;

- Marrë miratimin paraprak sipas përkrahimit të pozicionit të punës për pozicionet konkrete, referuar përcaktimeve në legjislacionin në fuqi.

- Përcjellë me shkresë zyrtare në strukturën përgjegjëse për financat për aplikim në masën dhe personat që do të trajtohen me këtë shtesë në page.

*Niveli i riskut: I Mesëm*

*Afati i zbatimit: Menjëherë*

**Statusi i rekomandimit: Zbatuar plotësisht.** Gjetja dhe rekomandimi përkatës i referohet punonjësit të IT-së. Për këtë i është dërguar DAP, shkresa nr.424 datë 12.9.2023 ku kërkohet përcaktimi të masës së shtesës për natyrë të veçantë për specilaistin e IT. Me shkresën nr.4588/1 datë 9.10.2023 të DAP ka ktheur përgjigje që në pikën 26 të lidhjes nr.3 të VKM nr.325 datë 31.5.2023, DAP nuk autorizohet për miratimin paraprak të shtesave për natyrë të veçantë pune, si rrjedhim, zbatimi i shtesave bëhet rast pas rasti nga vetë institucionet, pa marrë miratimin e DAP. Në vijim zv/Kryetari i Gjykatës me Urdhër të brendshëm nr.486 datë 23.10.2023 ka urdhëruar pagesën e shtesës për natyrë të veçantë pune për punonjës të IT-së.

**Rekomandimi nr.13:** Të përditësohet regjistri aktiveve me të dhënat mbi kohën dhe vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes së aktiveve. Të plotësohen të dhënat specifike (si lloji, marka, numri serial, kodi etj) në inventarin kontabël të pajisjeve elektronike që janë në përdorim nga punonjësit e gjykatës për ti bërë të dallueshme ato nga njëra tjetra dhe për të siguruar përputhje midis tyre dhe të dhënave të gjendjeve fizike dhe mos tjetërsim të tyre.

*Niveli i riskut: I Mesëm*

*Afati i zbatimit: Menjëherë*

**Statusi i rekomandimit: Zbatuar plotësisht.** Janë mbajtur kartelat për mjetet e transportit ku janë regjistruar shpenzimet e mirëmbajtjes. Për ndërtesën gjatë kësaj periudhë nuk ka patur shpenzime të mirëmbajtjes për ti regjistruar në regjister të aktiveve. Është bërë evidentimi nga komisioni i inventarizimit dhe specilaisti i IT të dhënave specifike si lloji, marka, numri serial i pajisjeve elektronike që janë në përdorim nga punonjësit e gjykatës.

- **Rekomandime të karakterit organizativ**

**Rekomandimi nr.11:** Në kuadër të ristrukturimit të gjykatës, struktura përgjegjëse të marrë masa për:

-Sistemimin e të dhënave kontraditore ne raportim/planifikim me te dhenat ne fakt sipas miratimit të bërë nga KLGJ, për pozicionin e punës Ndihmës ligjor.

- Të kërkohet në organin qendror:

## RAPORT AUDITIMI

---

- saktësimi i numrit të Ndimësve ligjor në organikë.
- shtesë në organikë, për pozicionin e punës Ndhmës Ligjor në raport me numrin e gjyqtarëve në organikë, sipas përcaktimeve ligjore.

*Niveli i riskut: I Mesëm*

*Afati i zbatimit: Menjëherë*

**Statusi i rekomandimit: Zbatuar plotësisht.** Me Vendimin e Këshillit të Gjykatës nr.78, nr. prot. 533, datë 30.11.2023 “Për miratimin e strukturës organizative, organigramës dhe përshkrimeve të detyrave e përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësore dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës Administrative të Apelit”, i cili është përcjellë në KLGJ bazuar në numrin e përgjithshëm të punonjësve të miratuar, është miratuar struktura organizative dhe organigrama e gjykatës me 80 punonjës, ku numri ndihmësve ligjorë është përcaktuar 13.

**Rekomandimi nr.12:** Nëpunësi Autorizues të marrë masa për krijimin e kushteve që veprimet e arkës të kryhen nga punonjësi me përgjegjësi materiale i ngarkuar me këtë detyrë.

Nëpunësi Zbatues të marrë masa për mbajtjen e librit të arkës nga arkëtari në përputhje me rregullat kontable, prerjen e m.arkëtimeve dhe m.pagesave (veprimeve cash) dhe regjistrimin në kontabilitet në momentin e ndodhjes së veprimit. Njëkohësisht të marrë masa për inventarizimin fizik të arkës jo më pak se një herë në muaj, dokumentimin e kryerjes së tij dhe bërjen pjesë të dokumentacionit të arkës.

*Niveli i riskut: I Mesëm*

*Afati i zbatimit: Menjëherë*

**Statusi i rekomandimit: Zbatuar plotësisht.** Veprimet e arkës kryhen nga punonjësi me përgjegjësi materiale i ngarkuar me këtë detyrë. Janë prerë m.arkëtime dhe m.pagesa (veprimeve cash), është hapur libri i arkës. Nga nëpunësja zbatuese është bërë regjistrimi në kontabilitet në momentin e ndodhjes së veprimit dhe ka bërë inventarizimin fizik periodik të gjendjes së arkës.

Nga verifikimi dhe vlerësimi i monitorimit, mbi ecurinë dhe progresin që është bërë për zbatimin e 13 rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm, rezulton se: janë zbatuar 6 ose 46 %, në proces zbatimi (papërfunduar plotësisht) 7 ose 54 % dhe të pa zbatuara, ska. Për 7 rekomandimet në proces, janë marrë masat e duhura për zbatimin e tyre.

**Opinion i përgjithshëm:** Gjykata ka vlerësuar rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm. Masat e marra për zbatimin e tyre kanë ndikuar në përmirësimin e funksionimit të veprimtarisë dhe arritjen e objektivave. Duhet të vazhdohet me monitorimin, ndjekjen dhe zbatimin e plotë të 7(shtatë) rekomandimeve që janë në proces zbatimi (të papërfunduara plotësisht).

Rezultatet e verifikimit janë pasqyruar në Pasqyrën nr.2 bashkalidhur raportit.

**Raporti Auditimit hartohet në 3 (tre) kopje, nga 1(një) kopje administrohen nga DAB-ja, dhe zyra e protokollit dhe 1 (një) kopjet i dërgohet gjykatës.**

**Grupi i Auditimit**

Agim Koçi

Auken Herri

Verifikimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm për vitin 2023

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	
				GJETJET						
Viti i kryerjes se auditimit	Subjekti i audituar	Data e Raportit Perfundimtar te Auditimit	Lloji i Auditimit	Sistemi /Fusha	Nensistemi	Niveli i Riskut	Përgjigja e subjektit	Afati i implementimit te rekomandimit	Satusi Rekomandimit	
2023	Gjykata Administrative e Apelit	4660/3 Prot., datë 12.12.2023	Auditim i Kombinuar							
1	Në kuadër të ristrukturimit të gjykatës, struktura përgjegjëse të marrë masa për: -Sistemimin e të dhenave kontraditore ne raportim/planifikim me te dhenat ne fakt sipas miratimit të bërë nga KLGJ, për pozicionin e punës Ndhmës ligjor. - Të kërkohet në organin qendror: - saktësimi i numrit të Ndimësve ligjor në organikë. - shtesë në organikë, për pozicionin e punës Ndhmës Ligjor në raport me numrin e gjyqtarëve në organikë, sipas përcaktimeve ligjore.		Auditim i Kombinuar	1 Qeverisja dhe administrimi	1.2 vendimarrja dhe mbikqyrja	I mesem	Pranuar plotesisht	Rekomandimi te zbatohet menjhere	Zbatuar Plotesisht	
2	Gjykata në bashkëpunim me organin qendrorë (për sigurimin e fondeve), duke analizuar dobësitë, të hartohet një plan veprimi për garantimin e rregullit te sigurisë në gjykatë në përputhje me standardet e kerkuara.		Auditim i Kombinuar	1 Qeverisja dhe administrimi	1.2 vendimarrja dhe mbikqyrja	I mesem	Pranuar plotesisht	Rekomandimi te zbatohet brenda 6 muajve	Ne proces zbatimi por paperfundu plotesisht	
3	Gjykata për një administrim më efektiv dhe rritjen e sigurisë fizike në Dhomën e Serverave në drejtim të uljes së riskut, në bashkëpunim me organin qendrorë(për sigurimin e fondeve) të marrë masat e nevojeshme për përmirësimin e kushteve të sigurisë, sipas standardeve te miratuara për ndertimin dhe administrimin e dhomes se serverave per Sistemin e Drejtësisë.		Auditim i Kombinuar	1 Qeverisja dhe administrimi	1.3 Menaxhimi I Riskut	I mesem	Pranuar plotesisht	Rekomandimi te zbatohet brenda 6 muajve	Ne proces zbatimi por paperfundu plotesisht	
4	Te krijohen kushtet teknike dhe teknologjike per ruajtjen dhe sigurine fizike Te dokumentave ne zyren e arkives. - Te perdoret vetem nje regjister korespondence per regjistrimin e shkresave hyrse, dalse dhe Te brendshme. - Te ngrihet komisioni i ekspertizes, per hartimin e listes konkrete me afatet e ruajtjes se dokumentave Te gjykatës.		Auditim i Kombinuar	1 Qeverisja dhe administrimi	1.3 Menaxhimi I Riskut	I mesem	Pranuar plotesisht	Rekomandimi te zbatohet brenda 6 muajve	Ne proces zbatimi por paperfundu plotesisht	

5	Grupi i punës për përgatitjen e PBA-së (EMP) për një planifikim gjithëpërfshirës e sa më real të nevojave të ketë në përbërje të gjithë drejtuesit e aktiviteteve/strukturave të gjykatës; planifikimi dhe paraqitja të treguesve buxhetorë të jetë për të tre vitet e periudhës së programit buxhetor afatmesëm; të administrohet i gjithë dokumentacioni bazë i përgatitjes së PBA-së lidhur me kërkesat për mallra e shërbime nga çdo sektor/strukturë, analizimin e tyre bazuar në normativa/eksperiencat e mëparshme si dhe mënyrën e përlogaritjes së vlerës së kërkesave.		Auditim i Kombinuar	2 Planifikimi dhe buxhetimi	2.1 Planifikimi Buxhetor	I mesem	Pranuar plotesisht	Rekomandimi të zbatohet menjherë	Ne proces zbatimi por I paperfunduar plotesisht
6	Përgatitja e raporteve periodike dhe vjetore të monitorimit të zbatimit të buxhetit vjetor dhe performancës financiare të analizohen në GMS/ Këshillin e Gjykatës ku përveç evidentimit të arsyeve dhe shkaqeve të mospërputhjeve midis planit dhe faktit të treguesve të shoqërohet me përcaktimin e miratimit e veprimeve që duhet të ndërmerren për përmirësimin e performancës financiare në uljen e kostos për çështje të gjykuar.		Auditim i Kombinuar	2 Planifikimi dhe buxhetimi	2.3 Monitorimi zbatimit Buxhetit Shtetit	I mesem	Pranuar plotesisht	Rekomandimi të zbatohet menjherë	Ne proces zbatimi por I paperfunduar plotesisht
7	Njesia e Prokurimit të tregojë me shumë kujdes në hartimin dhe argumentimin e kriterëve të veçanta të kualifikimi. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Në mënyrë që të eliminohet zgjatja e panevojshme të procedurave të prokurimit, sigurimi i konkurrencës dhe barazia në tendera.		Auditim i Kombinuar	3 Prokurimi	3.2 Procesi tenderimit	I mesem	Pranuar plotesisht	Rekomandimi të zbatohet menjherë	Ne proces zbatimi por I paperfunduar plotesisht
8	Në kushtet e vendosura në ftesën për ofertë dhe në kontratën e furnizimit me karburant, të përcaktohet qartë që furnizimi /ngarkimi në sistemin elektronik të administrimit të karburantit të jetë në bazë të kërkesave periodike mujore të gjykatës dhe faturimi nga kontraktori/shitesi të jetë në fund të çdo periudhe/muaji për sasinë e karburantit të konsumuar. Mbi bazën e faturës të blerjes periodike/mujore të pritët flet hyrja e shoqëruar me raportin nga sistemi elektronik i administrimit të karburantit dhe kuponat tatimorë të furnizimit të çdo mjeti dhe njëkohësisht të pritët fletëdalja (dokumenti vërtetues) e cila të shoqërohet me fletë udhëtimet e dorëzuara nga drejtuesi i mjetit për justifikimin e konsumit të karburantit.		Auditim i Kombinuar	3 Prokurimi	3.2 Procesi tenderimit	I mesem	Pranuar plotesisht	Rekomandimi të zbatohet menjherë	Ne proces zbatimi por I paperfunduar plotesisht
9	Për çdo pozicion pune vakant, të zhvillohet procedura e rekrutimit/ pranimit në punë. Të mos emërohen punonjës që nuk përmbushin kriteret e veçanta të pozicionit të punës/ emërimi të behet me konkurim të hapur. Të nderpriten marrëdhënjet financiare/ punës me sekretarin gjyqësor (A.T).		Auditim i Kombinuar	4 Menaxhimi Burimeve Njerezore	4.1 Rekrutimi	I mesem	Pranuar plotesisht	Rekomandimi të zbatohet menjherë	Zbatuar Plotesisht

10	Struktura përgjegjëse për burimet njerëzore të marrë masa duke rishikuar dhe sistemuar vjetërsinë në punë të dokumentuar në librezat e punës duke llogaritur si vite pune per efekt të kësaj shtese përcaktimet në aktet ligjore në fuqi. Struktura përgjegjëse për financat të bëjë sistemitet përkatëse nese rezultojnë diferenca në shtesën e pagës dhënë për vjetërsinë në punë, duke bërë dhe sistemitet në pagë për rastet e konstatuara.		Auditim i Kombinuar	5 Pagat dhe shperblimet	5.1 Perlogaritja e pagave	I mesem	Pranuar plotesisht	Rekomandimi te zbatohet menjhere	Zbatuar Plotesisht
11	Struktura përgjegjëse për burimet njerëzore të marrë masa për kategoritë e punonjësve që trajtohen me shtesë për natyrë të veçantë pune duke; - Marrë miratimin paraprak sipas përshkrimit të pozicionit të punës për pozicionet konkrete, referuar përcaktimeve në legjislacionin në fuqi. - Përcjellë me shkresë zyrtare në strukturën përgjegjëse për financat për aplikim në masën dhe personat që do të trajtohen me këtë shtesë në pagë.		Auditim i Kombinuar	5 Pagat dhe shperblimet	5.1 Perlogaritja e pagave	I mesem	Pranuar plotesisht	Rekomandimi te zbatohet menjhere	Zbatuar Plotesisht
12	Nëpunësi Autorizues të marrë masa për krijimin e kushteve që veprimet e arkës të kryhen nga punonjësi me përgjegjësi materiale i ngarkuar me këtë detyrë. Nëpunësi Zbatues të marrë masa për mbajtjen e librit të arkës nga arkëtari në përputhje me rregullat kontable, prerjen e m.arkëtimeve dhe m.pagesave (veprimeve cash) dhe regjistrimin në kontabilitet në momentin e ndodhjes së veprimit. Njëkohësisht të marrë masa për inventarizimin fizik të arkës jo më pak se një herë në muaj, dokumentimin e kryerjes së tij dhe bërjen pjesë të dokumentacionit të arkës.		Auditim i Kombinuar	6 Raportimi Financiar dhe Kontabiliteti	6.6 Rregjistrimet ne kontabilitet	I mesem	Pranuar plotesisht	Rekomandimi te zbatohet menjhere	Zbatuar Plotesisht
13	Të përditësohet regjistri aktiveve me të dhënat mbi kohën dhe vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes së aktiveve. Të plotësohen të dhënat specifike (si lloji, marka, numri serial, kodi etj) në inventarin kontabël të pajisjeve elektronike që janë në përdorim nga punonjësit e gjykatës për ti bërë të dallueshme ato nga njëra tjetra dhe për të siguruar përputhje midis tyre dhe të dhënave të gjendjeve fizike dhe mos tjetërsim të tyre.		Auditim i Kombinuar	7 Aktivet e Qendrushme	7.1 Plotesia	I mesem	Pranuar plotesisht	Rekomandimi te zbatohet menjhere	Zbatuar Plotesisht

**Grupi i auditimit**

Agim Koci

Auken Herri





Zv Kryetar i Gjykatës  
Ardian Dvorani

Kancelari  
Leonard Shkalla

K/Degës së Buxhetit  
Mimoza Dedja

